



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
Ndermarrja Gjellberimit, Parqeve e Rekreacionit

Kamëz, më 08/08/2025.

PROÇES-VERBAL - Tipi i kontratës - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: “Blerje Kamionçina”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 34136200-1 kamioncina;

I.1 Vlera e fondit limit 3,666,666 (Tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor : **Ndërmarrja Gjellberimit, Parqeve e Rekreacionit, Kamez** (njësia e prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, në masën 2% të vlerës së përllogaritur të kontratës në një nga format e parashikuara në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore përgjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e përlogaritur të kontratës, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se përcaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuar nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor Ndermarrja Gjellbërimit, Parqeve e Rekreacionit Kamez, gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e të ngjashme në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose faturat tatimore të shitjes, ku të jenë saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

Ose

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotëuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në oraganet tatimore, ku të jenë saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a. 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatë ISO 9001- 2015 “Mbi menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente për objektin mall prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë Çertifikatë ISO 9001- 2015 “Mbi menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente bazohet në nevojën për të garantuar që ofertuesi ka vendosur sisteme të dokumentuara dhe të certifikuara për menaxhimin cilësisë në përputhje me standartet ndërkombëtare. Ky standart ndërkombëtar siguron: organizimin dhe menaxhimin e proceseve të punës në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar; gjurmueshmëri dhe dokumentim të plotë të proceseve të prodhimit; zbatimin e procedurave për kontrollin e cilësisë dhe parandalimin e defekteve. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin e mallrave/shërbimeve ku cilësia e produktit final ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e qëllimit të kontratës, posedimi i një çertifikate të tillë është një element thelbësor për të siguruar që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm organizativ dhe teknik për ta realizuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

2.3.3 Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa që çertifikata e përcaktuar në pikën e mëparshme të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akredituese të njohur nga Republika e Shqipërisë, ka për qëllim të garantojë vlefshmërinë dhe besueshmërinë e certifikatës së paraqitur nga operatori ekonomik.

Akreditimi i organit lëshues siguron që: procesi i certifikimit është kryer në përputhje me standartet ndërkombëtare të vlerësimit të konformitetit; organet lëshues janë të kualifikuara dhe të njohura zyrtarisht për kompetencën e tyre; reduktohet rreziku i paraqitjes së certifikatave të pavlefshme ose të paautorizuara; garantohet trajtimi i barabartë dhe konkurrenca e ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë. Kjo kërkesë është në përputhje me parimet e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të cilat synojnë sigurimin e një gare transparente, konkurruese dhe të ndershme, duke u bazuar

vetëm në dokumentacion të verifikueshëm dhe të besueshëm. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor minimizon rrezikun e kontraktimit me operatorë që nuk përmbushin realisht standardet e kërkuara të cilësisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë VII.3.B për shit- blerje automjetesh.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë Licencë tip VTL.3.B për shit- blerje automjetesh bazohet në nevojën për të siguruar që subjekti që merr pjesë në procedurën e prokurimit ka të drejtën ligjore dhe kapacitetin profesional për të ushtruar aktivitetin e shit-blerjes së automjeteve, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Posedimi i kësaj licence garanton se: operatori ekonomik është i regjistruar dhe i autorizuar nga autoritetet kompetente për të kryer aktivitetin e tregtimit të automjeteve; aktiviteti ushtrohet në përputhje me rregulloret ligjore dhe fiskale në Republikën e Shqipërisë janë respektuar standardet e sigurisë dhe dokumentacionit për shit-blerjen e automjeteve; reduktohet rreziku i përfshirjes në transaksione të paligjshme ose të parregullta.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë në SPE skedën teknike të mjetit, certifikatën e origjinës nga fabrika, autorizim prodhuesi ose distributori, lejen e qarkullimit shqiptare, në mënyrë që AK të verifikoj kërkesat teknike.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të dorëzojë në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) skedën teknike të mjetit, certifikatën e origjinës nga fabrika, autorizim prodhuesi ose distributori, lejen e qarkullimit shqiptare, ka për qëllim të garantojë që Autoriteti Kontraktor (AK) të ketë mundësinë të verifikojë përputhshmërinë e automjetit të ofruar me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Dorëzimi i këtyre dokumenteve siguron se: mjeti i ofruar ka specifikat teknike të sakta dhe të verifikuara nga një autoritet kompetent; origjina e mjetit është e qartë dhe e dokumentuar zyrtarisht, duke shmangur rrezikun e mjeteve të përdorura pa standarde ose të kontrabanduara; leja e qarkullimit shqiptare, kur është e aplikueshme, tregon se mjeti është i regjistruar dhe i lejuar për qarkullim sipas rregullave të Republikës së Shqipërisë; procesi i vlerësimit teknik nga AK bëhet mbi bazën e të dhënave reale dhe të verifikueshme, duke shmangur subjektivizmin dhe gabimet në vlerësim.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon një servis të licensuar për riparimin e difekteve të mjetit me një garanci 1 (një) vjeçare. Për këtë OE duhet të përshkruaj në deklaratë të gjitha të dhënat e servisit: Emrin e plotë, adresën, si dhe një kontakt (nr. teli ose email) me anë të të cilit A.K mund të kryejë verifikime e nevojshme.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë se disponon një servis të licensuar për riparimin e dëmeve dhe difekteve të mjetit për një afat 1(një) vjeçar ka për qëllim të garantojë që, pas dorëzimit të mjetit, çdo defekt apo dëmtim i mundshëm gjatë periudhës së garancisë të mund të riparohet nga një strukturë profesionale dhe e autorizuar, në përputhje me standardet ligjore dhe teknike në fuqi.

Disponimi i një servisi të licencuar siguron se: riparimet kryhen nga personel i kualifikuar dhe i trajnuar sipas standardeve të prodhuesit dhe legjislacionit shqiptar; përdoren pjesë këmbimi origjinale ose të miratuara, duke garantuar jetëgjatësinë dhe sigurinë e mjetit; shërbimi është i gjurmueshëm dhe dokumentohet zyrtarisht për çdo ndërhyrje teknike; zbatohet legjislacioni për mjedisin dhe sigurinë teknike në procesin e riparimit; reduktohet rreziku i vonesave, defekteve të përsëritura apo shërbimeve jo cilësore.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Njesia e Prokurimit